



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI**

VENDIM

Nr. 127, datë 07.12.2010

**PËR
MIRATIMIN E KUSHTEVE TË PËRGJITHSHME, SPECIMENIT DHE TARIFAT E
PRIMEVE TË KONTRATËS SË SIGURIMIT TË PASAGJERËVE NGA
AKSIDENTET NË TRANSPORTIN PUBLIK**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pikës 8, të Ligjit nr. 9572, datë 3.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, nenit 17, të Ligjit nr. 10 076, datë 12.2.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm së sektorin e transportit” dhe Ligjit nr. 9267, datë 29.07.2004 “Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime”, me propozim të Departamentit të Çështjeve Juridike, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Miratimin e kushteve të përgjithshme, specimenit dhe tarifave të primeve të kontratës së sigurimit të pasagjerëve nga aksidentet në transportin publik, të shoqërisë së sigurimit “Interalbanian” sh.a, sipas materialit bashkëlidhur.
2. Ngarkohen departamentet përkatëse për njoftimet në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR
Elisabeta GJONI**